



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-05

Prokurori kundër Salih Mustafës

Vendosi: Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 29 mars 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Materialet e Përdorura me Dëshmitarët W04484, W04485 dhe W04849
gjatë Dëshmisë së Tyre në Gjykatë dhe Provat e Mbledhura para Themelimit të
Dhomave të Specializuara**

me një Shtojcë Publike

T'i njoftohet:

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtjes së të akuzuarit

Julius von Bone

Mbrojtëses së Viktimave

Ani Puz

TRUPI GJYKUES I ("Trupi Gjykues") nxjerr këtë vendim mbi materialet e përdorura me dëshmitarët W04484, W04485 dhe W04849 gjatë dëshmisë së tyre në gjykatë dhe provat e mbledhura para themelimit të Dhomave të Specializuara ("DHS").

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 25 gusht 2021, Trupi Gjykues nxori Vendimin mbi Paraqitjen dhe Pranueshmërinë e Provave, ku përcaktoi parimet që rregullojnë pranimin e provave jोगजore në çështjen aktuale ("Vendimi i Pranueshmërisë").¹

2. Më 26 gusht 2021, Trupi Gjykues nxori Vendimin mbi Zhvillimin e Gjykimit ("Vendimi i Parë mbi Zhvillimin e Gjykimit"), në të cilin, ndër të tjera, urdhëroi palët dhe/ose mbrojtësen e viktimave, sipas rastit, që më së voni ditën e fundit të punës të çdo muaji kalendarik, të parashtrojnë kërkesat e tyre për pranimin e çdo materiali që paraprakisht nuk i është dorëzuar Trupit Gjykues dhe që është përdorur prej tyre gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve që kanë dëshmuar atë muaj.²

3. Më 21 janar 2022, Trupi Gjykues nxori Vendimin e Dytë mbi Zhvillimin e Gjykimit, në të cilin: (i) caktoi 4 shkurtin 2022 si datë të synuar për mbylljen e paraqitjes së provave prej Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS); (ii) urdhëroi palët dhe mbrojtësen e viktimave që deri në atë datë, ose deri në ditën e dytë të punës pasi dëshmitari i fundit i ZPS-së të ketë përfunduar dëshminë e tij, cilado të jetë data më e hershme, të dorëzojnë kërkesat e tyre për pranimin e materialeve të përdorura prej tyre gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve të mbetur të ZPS-së, bashkë me kundërshtimet dhe parashtrimet, nëse ka, për t'u dorëzuar brenda pesë ditësh nga ajo

¹ KSC-BC-2020-05, F00169, Trupi Gjykues I, *Vendim mbi Paraqitjen dhe Pranueshmërinë e Provave*, 25 gusht 2021, publik.

² KSC-BC-2020-05, F00170, Trupi Gjykues I, *Vendim mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 26 gusht 2021, publik, para. 37.

datë; dhe (iii) urdhëroi ZPS-në që deri në datën e lartpërmendur, apo në cilëndo datë të mëhershme, të dorëzojë kërkesë për pranimin e materialeve të mbetura të mbledhura para themelimit të DHS-së, ose të çfarëdo materiali tjetër.³

4. Po atë ditë, Trupi Gjykes autorizoi ZPS-në të shtonte në Listën e saj të Provave Materiale një dokument që përmban një listë të personave që pretendohet se janë mbajtur të ndaluar në prill 1999 dhe një numër shënimesh të shkruara me dorë (“dokumenti”).⁴

5. Më 31 janar 2022, ZPS-ja dorëzoi kërkesë për pranimin e provave materiale që përdori kur mori në pyetje dëshmitarët W04484 dhe W04485 (“Kërkesa e Parë e ZPS-së”).⁵ Mbrojtja e Salih Mustafës (përkatësisht, “Mbrojtja” dhe “i akuzuari”) dhe mbrojtësja e viktimave nuk dorëzuan përgjigje.

6. Më 4 shkurt 2022, ZPS-ja dhe Mbrojtja dorëzuan kërkesat e tyre për pranimin e materialeve që përdorën kur morën në pyetje dëshmitarin W04849 (përkatësisht, “Kërkesa e Dytë e ZPS-së”⁶ dhe “Kërkesa e Mbrojtjes”⁷). Nuk u dorëzuan përgjigje.

7. Po atë ditë, ZPS-ja dorëzoi kërkesë për pranimin e materialeve të mbetura të mbledhura para themelimit të DHS-së, ku kërkoi pranimin e dokumentit të

³ KSC-BC-2020-05, F00296, Trupi Gjykes I, *Vendim i Dytë mbi Zhvillimin e Gjykimit*, 21 janar 2022, publik, para. 21(a)-(c).

⁴ KSC-BC-2020-05, F00294, Trupi Gjykes I, *Vendim mbi Njoftimin e Prokurorit të Specializuar për Nxjerrje Materiali sipas Rregullës 102(4) të Rregullores*, 21 janar 2022, publik; *shih më tej*, F00302, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Listës së Përditësuar të Provave Materiale të Prokurorisë*, 1 shkurt 2022, publik, me shtojcën 1, konfidenciale.

⁵ KSC-BC-2020-05, F00301, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Pranimin e Provave Materiale nga Marrja në Pyetje prej Prokurorisë e Dëshmitarëve W04484 dhe W04485*, 31 janar 2022, publike, me shtojcën 1, konfidenciale.

⁶ KSC-BC-2020-05, F00305, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Pranimin e Provave Materiale nga Marrja në Pyetje prej Prokurorisë e Dëshmitarit W04849*, 4 shkurt 2022, publike, me shtojcën 1, publike.

⁷ KSC-BC-2020-05, F00311, Mbrojtja, *Kërkesë e Mbrojtjes për Pranimin e Provave Materiale nga Marrja në Pyetje prej Mbrojtjes e Dëshmitarit W04849*, 4 shkurt 2022, publike, me shtojcën 1, publike.

përmendur më lart (“Kërkesa e Tretë e ZPS-së”).⁸ Mbrojtja dhe mbrojtësja e viktimave nuk dorëzuan përgjigje.

II. PARASHTRIMET

8. Në Kërkesën e Parë të saj, ZPS-ja kërkon pranimin si prova të materialeve që përdori kur mori në pyetje dëshmitarët W04484 dhe W04485, konkretisht: (i) pjesët e deklaratave të mëparshme të këtyre dëshmitarëve, të cilave iu referua gjatë marrjes së tyre në pyetje; dhe (ii) materialet që iu treguan këtyre dëshmitarëve gjatë marrjes së tyre në pyetje.⁹ ZPS-ja parashton se dokumentet janë me rëndësi, autentike, kanë vlerë provuese dhe se pranimi i tyre nuk do të cenonte në mënyrë të papërligjur të akuzuarin.¹⁰ ZPS-ja shton se dëshmitarit W04485 iu treguan fotografi të cilat ishin pjesë e një pakete më të madhe dhe kërkon pranimin e gjithë paketës si provë materiale, në mënyrë që Trupi Gjykses të ketë një pasqyrë dhe kontekst më të plotë, duke përfshirë edhe informacion që lidhet me besueshmërinë dhe autenticitetin.¹¹

9. Në Kërkesën e Dytë të saj, ZPS-ja kërkon pranimin si prova të materialeve që përdori kur mori në pyetje dëshmitarin W04849, konkretisht: (i) pjesët e deklaratave të mëparshme të dëshmitarit W04849 të cilave iu referua gjatë marrjes së tij në pyetje; dhe (ii) materialin që iu tregua dëshmitarit gjatë marrjes së tij në pyetje.¹² ZPS-ja parashton se dokumentet janë me rëndësi, autentike, kanë vlerë provuese dhe pranimi i tyre nuk do të cenonte në mënyrë të papërligjur të akuzuarin.¹³

10. Në Kërkesën e saj, Mbrojtja kërkon pranimin si prova të materialeve që përdori kur mori në pyetje dëshmitarin W04849, konkretisht: (i) deklaratat e mëparshme të

⁸ KSC-BC-2020-05, F00306, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Pranimin e Materialit të Mbetur sipas Nenit 37 të Ligjit*, 4 shkurt 2022, publike, me shtojcat 1-2, konfidenciale.

⁹ Kërkesa e Parë e ZPS-së, para. 1, 5, 7; Shtojca 1 e Kërkesës së Parë të ZPS-së, që rendit materialet e përdorura.

¹⁰ Kërkesa e Parë e ZPS-së, para. 2.

¹¹ Kërkesa e Parë e ZPS-së, para. 6.

¹² Kërkesa e Dytë e ZPS-së, para. 1, 4, 6; Shtojca 1 e Kërkesës së Dytë të ZPS-së, që rendit materialet e përdorura.

¹³ Kërkesa e Dytë e ZPS-së, para. 2.

dëshmitarit W04849 të cilave iu referua gjatë marrjes së tij në pyetje; dhe (ii) materialin që iu tregua dëshmitarit gjatë marrjes së tij në pyetje.¹⁴ Mbrojtja parashtron se dokumentet janë me rëndësi, autentike dhe kanë vlerë provuese.¹⁵

11. Në Kërkesën e Tretë të saj, ZPS-ja kërkon pranimin si provë të dokumentit të lartpërmendur.¹⁶ ZPS-ja parashtron se dokumenti është pjesë e një grupi të madh dokumentesh të gjetura nga forcat serbe në bazat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (“UÇK”), të cilat iu dorëzuan Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (“TPNJ”) dhe më pas iu dhanë Task Forcës Hetimore Speciale (“TFHS”).¹⁷ ZPS-ja shton se dokumenti është me rëndësi, ka vlerë provuese, përmban tregues të mjaftueshëm autenticiteti, dhe se pranimi i tij nuk do të cenonte në mënyrë të papërligjur të akuzuarin.¹⁸

III. LIGJI I ZBATUESHËM

12. Trupi Gjykses mban parasysht nenet 37 dhe 40(2), (5) dhe 6(h) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullat 24(1) dhe 137-139 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”).

13. Trupi Gjykses gjithashtu i referohet interpretimit të vet të kriterëve të pranueshmërisë sipas rregullës 138(1) të Rregullores, sikundër përcaktohet në Vendimin mbi Pranimin e Provave të Mbledhura para Themelimit të Dhomave të Specializuara dhe Materialeve të Tjera.¹⁹

¹⁴ Kërkesa e Mbrojtjes, para. 1; Shtojca 1 e Kërkesës së Mbrojtjes, që rendit materialet e përdorura.

¹⁵ Kërkesa e Mbrojtjes, para. 2.

¹⁶ Kërkesa e Tretë e ZPS-së, para. 1, 9.

¹⁷ Kërkesa e Tretë e ZPS-së, para. 5-6.

¹⁸ Kërkesa e Tretë e ZPS-së, para. 3.

¹⁹ KSC-BC-2020-05, F00281, Trupi Gjykses I, *Vendim mbi Pranimin e Provave të Mbledhura para Themelimit të Dhomave të Specializuara dhe Materialeve të Tjera*, 13 dhjetor 2021, konfidencial, para. 10-14. Versioni i redaktuar publik u lëshua po atë ditë, F00281/RED.

IV. ANALIZË

A. MATERIALET E PËRDORURA ME DËSHMITARËT W04484, W04485 DHE W04849 (KËRKESA E PARË E ZPS-SË, KËRKESA E DYTË E ZPS-SË, DHE KËRKESA E MBROJTJES)

14. Trupi Gjykses së pari vëren se dy materiale nga Kërkesa e Parë e ZPS-së²⁰ dhe një material nga Kërkesa e Dytë e ZPS-së,²¹ të cilat ZPS-ja kërkon t'i paraqesë si prova, tashmë janë pranuar si prova, ose janë të disponueshme për shqyrtim nga Trupi Gjykses në kuadër të aktgjykimit.²² Rrjedhimisht, pjesët e Kërkesës së Parë të ZPS-së dhe Kërkesës së Dytë të ZPS-së që kanë të bëjnë me këto materiale nuk është e nevojshme të shqyrtohen.

15. Së dyti, Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja gjithashtu kërkon të paraqesë si prova: (i) një kopje më të lexueshme të njërit prej materialeve tashmë të disponueshëm për shqyrtim nga Trupi Gjykses në kuadër të aktgjykimit;²³ një kopje të një materiali tjetër tashmë të disponueshëm për shqyrtim, të shënuar nga dëshmitari W04849 gjatë marrjes së tij në pyetje nga pala thirrëse.²⁴ Asnjëra prej këtyre kopjeve nuk është paraqitur më parë si provë. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses do t'i shqyrtojë ato në vendimin aktual.

16. Duke iu kthyer materialeve të mbetura të cilat palët kërkojnë t'i paraqesin si prova nëpërmjet Kërkesës së Parë të ZPS-së, Kërkesës së Dytë të ZPS-së dhe Kërkesës së Mbrojtjes, Trupi Gjykses nuk e vlerëson të nevojshme të ushtrojë kompetencën e vet diskrecionale për përjashtimin e ndonjërit prej tyre. Rrjedhimisht, në pajtim me

²⁰ Shtojca 1 e Kërkesës së Parë të ZPS-së, materialet 3, 6 (duke mos përfshirë kopjen U000-9804-U000-9804).

²¹ Shtojca 1 e Kërkesës së Dytë të ZPS-së, materiali 7.

²² *Shih*, KSC-BC-2020-05, F00281/RED, Trupi Gjykses I, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Pranimin e Proovave të Mbledhura para Themelimit të Dhomave të Specializuara dhe Materialeve të Tjera*, 13 dhjetor 2021, publik, para. 19, 24, 26(e), (f); që i referohet F00201/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Kërkesës së Prokurorisë për Pranimin e Materialeve Jogojore*, 13 shtator 2021, konfidenciale, materialet 49, 67, 74.

²³ Shtojca 1 e Kërkesës së Parë të ZPS-së, materiali 3: U000-9804-U000-9804.

²⁴ Shtojca 1 e Kërkesës së Dytë të ZPS-së, materiali 7: REG0102, që është nga SPOE00238094-00238094.

Vendimin e Pranueshmërisë dhe Vendimin e Parë mbi Zhvillimin e Gjykimit, Trupi Gjykses nuk do të ushtrojë kompetencën e vet diskrecionale për të vendosur për secilin material veç e veç dhe do t'i konsiderojë të gjitha këto materiale të disponueshme për Trupin Gjykses në kuadër të kuvendimeve për aktgjykimin në lidhje me fajësinë apo pafajësinë e të akuzuarit,²⁵ me kushtin e mëposhtëm.

17. Lidhur me deklaratat e mëparshme të dëshmitarëve W04484, W04485 dhe W04849,²⁶ Trupi Gjykses rikujton se, në pajtim me parimin e paraqitjes së dëshmimeve gojore, do të merren parasysh vetëm ato pjesë që janë diskutuar me dëshmitarët gjatë dëshmisë së tyre gojore në gjykatë.²⁷ Në pajtim me paragrafin 37 të Vendimit të Pranueshmërisë, e njëjta gjë vlen edhe për pjesët përkatëse të të gjitha audio dhe videoincizimeve të deklaratave të mëparshme në fjalë.²⁸

18. Krahas materialeve të lartpërmendura dhe/ose pjesëve të tyre të paraqitura si prova materiale nga palët, Trupi Gjykses *proprio motu* do të shqyrtojë gjithashtu: (i) pjesët e deklaratës së mëparshme të W04484-ës, të përdorura nga Trupi Gjykses gjatë pyetjeve të Trupit Gjykses për dëshmitarin,²⁹ sikundër janë pasqyruar në transkript dhe evidentuar nga Njësia e Administrimit të Gjykatës (NJAGJ) për nevoja

²⁵ Vendimi i Pranueshmërisë, para. 21; Vendimi i Parë mbi Zhvillimin e Gjykimit, para. 37.

²⁶ Shtojca 1 e Kërkesës së Parë të ZPS-së, materialet 1-2, 4-5, 7-8; Shtojca 1 e Kërkesës së Dytë të ZPS-së, materialet 1-6; Shtojca 1 e Kërkesës së Mbrojtjes, materiali 1.

²⁷ *Shih* KSC-BC-2020-05, Transkript i seancës, 4 tetor 2021, publik, f. 852, rreshti 14 deri në f. 854, rreshti 21. Trupi Gjykses vëren se gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit W04849, ZPS-ja deklaroi se po përdorte pjesën e mëposhtme të deklaratës së mëparshme të dëshmitarit, ndër të tjera: 1000954-TR-ET Part 3, f. 8, rreshtat 23-25 dhe f. 9, rreshtat 8-13 (*shih*, KSC-BC-2020-05, Transkript i seancës, 1 shkurt 2022, publik, f. 2362, rreshti 16 deri në f. 2363, rreshti 6). Megjithatë, Trupi Gjykses vëren se ZPS-ja në fakt po i referohej 1000954-TR-ET Part 3, f. 7, rreshtat 23-25 dhe f. 8, rreshtat 8-13. Rrjedhimisht, Njësia për Administrimin e Gjykatës e Zyrës Administrative udhëzohet ta evidentojë këtë pjesë të deklaratës së mëparshme të W04849-ës në përputhje me sa më lart.

²⁸ Shtojca 1 e Kërkesës së Parë të ZPS-së, materialet 2, 5; Shtojca 1 e Kërkesës së Dytë të ZPS-së, materiali 5.

²⁹ 069889-TR-ET, Part 1, Part 2 RED 1 (përfshirë versionin përkatës në shqipe, 069889-TR-AT Part 1 Revised, Part 2 Revised RED 1, dhe audio dhe videoincizimin përkatës 069889b, Part 1, Part 2 Partial 1, Part 2 Partial 2).

administrative;³⁰ (ii) pjesët e deklaratës së mëparshme të W04485-ës të përdorura nga Mbrojtja dhe Trupi Gjykes gjatë pyetjeve të tyre përkatëse për dëshmitarin,³¹ sikundër janë pasqyruar në transkript dhe evidentuar nga NJAGJ-ja për nevoja administrative; (iii) materialin 104784-104833 të përdorur nga ZPS-ja gjatë pyetjeve të saj për dëshmitarin W04849;³² dhe (iv) pjesët e deklaratave të mëparshme të W044849-ës të përdorura nga Trupi Gjykes gjatë pyetjeve të Trupit Gjykes për dëshmitarin,³³ sikundër janë pasqyruar në transkript dhe evidentuar nga NJAGJ-ja për nevoja administrative.

19. Trupi Gjykes rikujton se për sa i takon pranimit të materialeve të gjata, si rregull i përgjithshëm, materiale të tilla shqyrtohen në tërësinë e tyre, me qëllim që Trupi Gjykes të ketë mundësi të vlerësojë kuptimin e saktë dhe kontekstin më të gjerë të pjesës ose pjesëve të përdorura nga palët, sipas rastit.³⁴ Rrjedhimisht, Trupi Gjykes do të shqyrtojë në tërësinë e tij materialin 104784-104833 që përdori ZPS-ja gjatë pyetjeve të saj për dëshmitarin W04849.

20. Së fundi, në pajtim me paragrafin 37 të Vendimit të Pranueshmërisë, çdo version i mëvonshëm i paredaktuar apo me më pak redakte i materialeve të trajtuara në vendimin aktual, do të shqyrtohet automatikisht nga Trupi Gjykes gjatë kuvendimeve për aktgjykimin, duke marrë parasysh çdo kundërshtim që mund të kenë palët dhe mbrojtësja e viktimave.³⁵ Për evidentimin e saktë të procesit, në rast të nxjerrjes në të ardhmen të ndonjë versioni të paredaktuar apo me më pak redakte

³⁰ *Shih urdhrin gojor* në lidhje me këtë pikë: KSC-BC-2020-05, Transkript i seancës, 2 nëntor 2021, publik, f. 1281, rreshtat 10-23.

³¹ 069474-TR-ET, Part 1 RED, Part 2, Part 3 (përfshirë versionin përkatës në shqipe 069474-TR-AT, Part 1 Revised RED, Part 2 Revised, Part 3 Revised, dhe audio dhe videoincizimin përkatës, 069474b, Part 1 Partial 1, Part 1 Partial 2, Part 2, Part 3).

³² Duke përfshirë edhe përkthimet (e pjesshme) përkatëse në anglishte, 104803-104804-ET, 104816-104818-ET, 104820-104820-ET, 104832-104833-ET.

³³ 100954-TR-ET Part 1 RED, Part 2 (duke përfshirë versionin përkatës në shqipe, 100954-TR-AT Part 1 RED, Part 2, dhe audio dhe videoincizimin përkatës, 100954b, Part 1, Part 2); DSM00100-00118 (duke përfshirë versionin përkatës në shqipe, DSM00100-DSM00118-AT).

³⁴ Vendimi i Pranueshmërisë, para. 38; Vendim i Parë mbi Zhvillimin e Gjykimit, para. 38.

³⁵ *Shih gjithashtu*, Vendimi i Parë mbi Zhvillimin e Gjykimit, para. 38.

të këtyre materialeve, pala nxjerrëse e informon menjëherë palën tjetër, mbrojtësen e viktimave, Trupi Gjykses dhe NJAGJ-së për nxjerrjen. Kjo do t'i mundësojë NJAGJ-së që në sistemin *Legal Workflow* të lidhë çdo version të mëvonshëm të paredaktuar apo me më pak redaktime me versionin që konsiderohet pjesë e provave për kuvendimet dhe aktgjykimin e Trupi Gjykses, në përputhje me vendimin aktual. Në rast të kundërshtimeve lidhur me versione të tilla të mëvonshme të paredaktuara apo me më pak redaktime, pala kundërshtare apo mbrojtësja e viktimave njoftojnë Trupin Gjykses brenda pesë ditësh nga njoftimi i nxjerrjes së tyre.

B. PROVA TË MBLEDHURA PARA THEMELIMIT TË DHS-SË (KËRKESA E TRETË E ZPS-SË)

21. Trupi Gjykses vëren se dokumenti që ZPS-ja kërkon të paraqesë si provë³⁶ përmban një listë të personave të cilët pretendohet se u arrestuan dhe mbajtën të ndaluar në prill të vitit 1999, periudhë që përket me kornizën kohore të akuzave të ngritura kundër të akuzuarit.³⁷ Në dokument përmenden të dhënat personale të të ndaluarve (emri, mbiemri, emri i babait, datëlindja dhe vendlindja), data e arrestimit dhe data e lirimit të tyre. Trupi Gjykses rrjedhimisht është bindur se dokumenti ka lidhje me akuzat në këtë çështje gjyqësore.

22. Gjithashtu, Trupi Gjykses vë në dukje informacionin e dhënë nga hetuesi i ZPS-së në lidhje me prejardhjen e dokumentit, që vë në dukje se TFHS-ja e mori dokumentin nga TPNJ-ja si pjesë e një serie dokumentesh që thuhet se janë gjetur nga autoritetet serbe në bazat e UÇK-së gjatë 1998 dhe 1999.³⁸ Duke marrë parasysh këtë, Trupi Gjykses është bindur se dokumenti duket se është autentik dhe ka vlerë provuese.

³⁶ U001-0310-U001-0325 (përfshirë përkthimin përkatës në anglishte, U001-0310-U001-0322-ET); *shih*, Shtojca 1 e Kërkesës së Tretë të ZPS-së.

³⁷ *Shih*, KSC-BC-2020-05, F00019/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimit të Versionit të Redaktuar më tej të Aktakuzës së Konfirmuar*, 28 shtator 2020, publike, para. 35.

³⁸ Kërkesa e Tretë e ZPS-së, para. 5-6; Shtojca 2 e Kërkesës së Tretë të ZPS-së, para. 5, 7-9.

23. Së fundi, Trupi Gjykses vëren se Mbrojtja nuk e kundërshton pranimin e dokumentit si provë materiale dhe Trupi Gjykses është bindur se pranimi i tij nuk i shkakton asnjë cenim të akuzuarit. Bazuar në sa më lart, Trupi Gjykses e gjykon të përshtatshme pranimin e dokumentit si provë materiale.

24. Për lehtësi referimi, Trupi Gjykses i rendit të gjitha materialet e trajtuara në vendimin aktual në një shtojcë të këtij vendimi. Shtojca përmban të gjitha materialet të cilave duhet t'u jepet një numër prove. Duke qenë se në rastin e disa materialeve, vetëm pjesë të tyre janë në dispozicion të Trupi Gjykses për kuvendimet dhe aktgjykimin, këto pjesë do të shënohen në sistemin *Legal Workflow*, në fushën "Komente të Përgjithshme", sikundër janë pasqyruar në transkripte dhe evidentuar nga NJAGJ-ja për nevoja administrative.

V. VENDIM

25. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a. **MIRATON PJESËRISHT** Kërkesën e Parë të ZPS-së;
- b. **MIRATON PJESËRISHT** Kërkesën e Dytë të ZPS-së;
- c. **MIRATON** Kërkesën e Mbrojtjes;
- d. **MIRATON** Kërkesën e Tretë të ZPS-së dhe **PRANON** dokumentin si provë, përfshirë përkthimin e tij në anglishte;
- e. **URDHËRON** Administratoren t'u caktojë numra prove materialeve të renditura në shtojcën e këtij vendimi, sikundër përcaktohet në të, dhe t'i klasifikojë materialet si konfidenciale;
- f. **URDHËRON** Administratoren të pasqyrojë në fushën "Komente të Përgjithshme" në sistemin *Legal Workflow*, sipas rastit, pjesët e materialeve të renditura në shtojcën e këtij vendimi, të përdorura nga palët, mbrojtësja e viktimave dhe/ose Trupi Gjykses me secilin prej dëshmitarëve përkatës,

sikundër janë pasqyruar në transkripte dhe evidentuar nga NJAGJ-ja për nevoja administrative, apo siç vihet në dukje në poshtëshënimin 27 të këtij vendimi, sipas rastit;

- g. **URDHËRON** palën nxjerrëse të njoftojë menjëherë palën tjetër, mbrojtësen e viktimave, Trupin Gjykses dhe NJAGJ-në për nxjerrjen e çfarëdo versioni të mëvonshëm të paredaktuar apo me më pak redaktime të materialeve të renditura në shtojcën e këtij vendimi dhe **URDHËRON** Administratoren që në sistemin *Legal Workflow* të lidhë çdo version të tillë të mëvonshëm të paredaktuar apo me më pak redaktime me numrin ose numrat e provës materiale përkatëse, të caktuar në përputhje me këtë vendim; dhe
- h. **URDHËRON** palën që nuk nxjerr materialin dhe mbrojtësen e viktimave të parashtrajnë kundërshtimet e tyre lidhur me versione të tilla të mëvonshme të paredaktuara apo me më pak redaktime, brenda pesë ditësh nga njoftimi i nxjerrjes së tyre.

/nëshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia
Kryegjykatëse

/nëshkrimi/

Gjykatës Zhilber Biti

/nëshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E martë, 29 mars 2022

Hagë, Holandë.